




Nr. 12 prot
Dt. 11/04/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 10, datë 06.04.2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA
Z. LEKË PERAJ TE Z.STILJAN GUÇE.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.144/2 prot., datë 12.03.2018 “Leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare (Bar – Restorant Larje mjetesh motorike), nga z.Lekë Peraj me Nipt L47603504J te z.Stiljan Guçe me Nipt M27525502H, me vendndodhje: Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

X= 469956

Y= 4628263;

Z= 10 m.m.n.d

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime sanitare (Bar – Restorant Larje mjetesh motorike).

Sasia e ujit që jepet për përdorim: $Q = 0.5$ l/sek

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

